

# AGJENDA E BIDEN-IT:



**SI MUNDET ADMINISTRATA  
E RE T'I NDIHMOJË  
BALLKANIT PERËNDIMOR  
TË DALË NGA STAGNIMI**





**Autor:**

**Muhamet Brajshori**

Muhamet Brajshori është ish-zëvendësministër i Punëve të Jashtme të Kosovës. Ai më parë ka shërbyer si Ambasador në Tajlandë dhe vendet e ASEAN -it. Më parë ai ishte Zëvendës-Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe si këshilltar i Ministrave të Jashtëm të njëpasnjëshëm të Kosovës që nga viti 2012. Më parë ka punuar për Southeast European Times (SETimes), USAID BEEP dhe Bankën Botërore. Ai studioi marrëdhënie ndërkombëtare në Universitetin Uppsala dhe Universitetin Siegen dhe kaloi semestra kërkimore në Universitetet e Këlnit, Heidelberg, Turku dhe Staffordshire dhe flet rrjedhshëm anglisht dhe gjermanisht.

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Ndërlidhura mbron të drejtat dhe pronësinë intelektuale. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem mbajtës ose të transmetohet, në çfarëdo forme a me çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik a tjetër, pa lejen me shkrim nga botuesi. Përdorimi komercial i të gjitha mediave të publikuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) nuk lejohet pa miratimin me shkrim të QKSS. Ju lutemi kontaktoni: [info@qkss.org](mailto:info@qkss.org) ose +383 38 221 420.

Verzoni original është i përpiluar në gjuhën angleze. Ky version është përkthim nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.

# **AGJENDA E BIDEN-IT:**

**SI MUNDET ADMINISTRATA E RE T'I  
NDIHMUJË BALLKANIT PERËNDIMOR  
TË DALË NGA STAGNIMI**

# PËRMBAJTJA

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>1</b>
<b>KONTEKSTI .....</b>	<b>4</b>
<b>QASJA E POLITIKËS SË JASHTME TË BIDEN-IT .....</b>	<b>6</b>
<b>NGËRÇI KOSOVË-SERBI .....</b>	<b>8</b>
<b>NYJA BOSHNJAKE .....</b>	<b>12</b>
<b>RUSIA DHE KINA NË BALLKANIN PERËNDIMOR .....</b>	<b>14</b>
<b>AGJENDA DEMOKRATIKE NË BALLKANIN PERËNDIMOR.....</b>	<b>16</b>
<b>SIGURIA ENERGETIKE NË RAJON .....</b>	<b>18</b>
<b>REAGIMI NDAJ PANDEMISË COVID-19 NË BALLKANIN PERËNDIMOR .....</b>	<b>20</b>
<b>KONKLUZIONE .....</b>	<b>21</b>

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ndërkohë që shumë çështje në këtë rajon kanë mbetur të pazgjidhura, duke filluar nga mungesa e njohjes reciproke mes Kosovës dhe Serbisë, brishtësia politike e Bosnjës dhe Hercegovinës, e deri tek sfidat e reja si ndikimi kinez dhe rus, autokracia në rritje dhe mungesa e zhvillimit ekonomik, gjatë viteve të fundit SHBA-të kanë luajtur rol të dobët për avancimin e agjendave euro-atlantike. Sfidat aktuale në Ballkanin Perëndimor zvarriten prej dekadash. Nëse nuk trajtohen sfidat që pengojnë të ardhmen evropiane të rajonit, ngërçi do të kthehet në normë në Ballkanin Perëndimor, duke e lënë kështu rajonin pa një perspektivë të qartë për të ecur përpara. Presidenca e Joe Biden-it ka sjellë optimizëm në BE dhe vende si Kosova, ku lidershipi amerikan perceptohet si jetik për të manovruar në një mjedis ndërkombëtar gjithnjë e më shumë në ndryshim. Në të njëjtën kohë, lodhja nga agjenda e zgjerimit në BE e ka lënë rajonin në harresë duke përjetuar një stagnim politik që është përdorur nga akterë malinj për të zgjeruar ndikimin e tyre.

Administrata e Presidentit Biden ka dhënë shenja se synon të përqendrohet në rajon duke vendosur një politikë të bazuar në normativa për të adresuar çështjet që e fuqizojnë rajonin dhe i ndihmojnë rajonit të ndërmarrë reforma dhe të arrijë progres në integrimin euroatlantik. Një nga aspektet krye-sore të këtij ri-angazhimi do të jenë çështjet e ndjeshme politike që e mbajnë rajonin në ngërç, siç janë marrëdhëniet e ndërlikuara mes Kosovës dhe Serbisë, dhe risku që Bosnja dhe Hercegovina të kthehet në një shtet krejtësisht të dështuar në zemër të Evropës. Një element kyç i angazhimit të Uashingtonit do të jetë koordinimi më i ngushtë me aleatët evropianë për t'i përfunduar çështjet e mbetura të hapura në Ballkanin Perëndimor. Por sfidat janë të mëdha dhe pritjet janë të larta.

Kosova dhe Serbia janë larg normalizimit të marrëdhënieve dhe status quo-ja po i mban peng të dy shoqëritë duke i bërë të paaftha për të arritur progres drejt integritit evropian; Bosnja ende nuk arrin të ketë një shtet funksional, ndërsa rajoni po përjeton depërtim madhor kinez që do t'i sfidojë SHBA-të dhe BE-në kryesisht në vendet që po kalojnë recesion demokratik siç është Serbia. Këto dhe shumë çështje të tjera të tilla si pandemia, siguria energjetike dhe demokratizimi do të kërkojnë qartësi strategjike nga Uashingtoni dhe vendosmëri për të arritur progres. Rikthimi i rajonit në rrugën e duhur për demokratizimin, sundimin e ligjit dhe zgjerimin e BE-së do të kërkonte përfshirjen e administratës amerikane. Sfida themelore për paqe dhe stabilitet të qëndrueshëm në Ballkanin Perëndimor mbart riskun që Kosova dhe Bosnja dhe Hercegovina të kthehen në konflikte të ngrira. Nëse të dy vendet mund t'i zgjidhin sfidat e tyre dypalëshe dhe të brendshme respektivisht, rajonit i rriten shanset të ecë përpara në rrugën e bashkëpunimit dhe integritit evropian. Megjithatë, nëse çështjet e ndjeshme politike që i karakterizojnë të dy vendet shndërrohen në konflikte të ngrira, ekziston mundësia që akterët malinj të bëhen më aktivë dhe të pranishëm në rajon sesa janë aktualisht.

Nga ana tjetër, pavarësisht se sa e ndërlikuar mund të duket situata, arritja e progresit në rajon nuk është mision i pamundur. Mund të arrihet progres në luftimin e korrupsionit, zhvillimin ekonomik dhe forcimin e demokracisë, çka mund të ketë ndikim domethënës në trajtimin e çështjeve politike. Në të njëjtën kohë, kërkohet presion më i madh nga Uashingtoni mbi Bashkimin Evropian për ta zhbllokuar procesin e integritit evropian kundrejt Ballkanit

Perëndimor, përndryshe, çdo përpjekje e SHBA-ve në rajon nuk do të jetë efektive nëse procesi i integritetit mbetet i bllokuar për shkak të BE-së. Reformat, progresi drejt integritetit në BE dhe angazhimi amerikan do të duhej të shiheshin si cikël i ndërlidhur, jo si çështje të ndara.

Administrata e re e Biden-it ka shumë punë për të bërë në Ballkanin Perëndimor. Sfidat janë të shumta, por çelësi për tejkalimin e tyre, të paktën nga këndvështrimi i rajonit, duket të jetë vullneti politik në Uashington për t'u angazhuar vërtet me çështjet dhe për t'i çuar drejt integritetit në BE apo edhe në NATO vendet që i kanë këto qëllime. Vetëkënaqësia e mundshme në administratën e Biden-it me situatën në Ballkanin Perëndimor mund t'i përkeqësojë shanset për një konflikt të ngrirë në Kosovë dhe BeH dhe, në të njëjtën kohë, një provë vendimtare për administratën do të jetë menaxhimi i pritjeve brenda dhe jashtë Ballkanit Perëndimor. Përshtatja me rrethanat aktuale në rajon është domosdoshmëri për t'i adresuar në mënyrë më efektive sesa gjatë 4 viteve të fundit sfidat politike, ekonomike ose të sigurisë.

**1**

Administrata e Biden-it ka potencialin që në Ballkanin Perëndimor të tregojë përfshirje më të fortë dhe të punojë nga afër me partnerët evropianë, duke arritur të adresojnë sfidat kyçe në rajon dhe zhblokimin e status quo-së aktuale.

**2**

Administrata e Biden-it duhet të ketë qartësi në trajtimin e çështjeve politike në rajon. Do të duhej të kishte një fokus në arritjen e njohjes reciproke mes Kosovës dhe Serbisë duke respektuar sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës, por edhe mbrojtjen e rendit kushtetues dhe politik që ka qenë rezultat i negociatave të Vjenës në vitet 2006-2007 për statusin përfundimtar të Kosovës. Në të njëjtën kohë, në Bosnjë dhe Hercegovinë duhet të ndërmerren reforma politike dhe kushtetuese që synojnë forcimin e institucioneve qendrore dhe ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit.

**3**

Administrata e Biden-it duhet t'i japë fund mungesës së konsensusit se çfarë duhet bërë në Ballkanin Perëndimor. Veprimet e fundit nga Uashingtoni duket se sugjerojnë që administrata e Biden-it ka synime të qarta për adresimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, kontesteve të pazgjidhura dypalëshe/të brendshme, si dhe përfshirjes së akterëve të tretë në rajon, por duhet të jetë më e drejtpërdrejtë në strategji, kornizë kohore dhe resurse për të lëvizur në lidhje me këto dhe çështje dhe sfida të tjera me të cilat ballafaqohet Ballkani

**4**

*Rajoni duhet ta shfrytëzojë mundësinë që në Shtëpinë e Bardhë është një president amerikan që e njeh rajonin dhe për dekada ka qenë i përfshirë në mënyrë aktive me Ballkanin Perëndimor. Qeveritë duhet të tregojnë gatishmëri dhe aftësi për të ndërmarrë reforma transformuese dhe për t'i trajtuar sfidat politike dhe të sigurisë. Ato nuk mund të shpresojnë se Uashingtoni do t'i zgjidhë problemet e rajonit nëse nuk ka vullnet brenda rajonit për të ecur përpara. Kjo vlen veçanërisht për Kosovën dhe Bosnjë dhe Hercegovinën, të cilat janë sfiduar dhe penguar më së shumti nga ngërçi aktual.*

**5**

Transformimi më i rëndësishëm në Ballkanin Perëndimor do të konsistonte në fokusin në forcimin e demokracisë në rajon si kundërveprim ndaj përpjekjeve autoritare dhe në të njëjtën kohë luftimin e korrupsionit dhe forcimin e sundimit të ligjit si parakushte thelbësore për avancimin e të gjitha vendeve të rajonit. Administrata e Biden-it e ka pranuar nevojën për një angazhim më të fortë në këto fusha thelbësore për të ardhmen e Ballkanit Perëndimor, sepse risku i anashkalimit të kërcëni-meve aktuale ndaj demokracisë mund ta thellojë korrupsionin strategjik, krijimin e qeverive më të forta autoritare, dhe forcimin e pranisë së Rusisë dhe Kinës në mbarë rajonin.

**6**

Veprimet e fundit të Shteteve të Bashkuara për shpërndarjen e vaksinave dhe adresimin e sfidave të pandemisë Covid-19, të cilat janë detyrimisht ekonomike, janë gjithashtu tregues të nevojës për një fokus më të madh në investimet dhe projektet e infrastrukturës, jo vetëm për zhvillimin e ekonomive të rajonit por edhe për të shmangur praninë e akterëve malinj në rajon. Siguria energjetike, ku ka mundësi të mëdha për sukses, përfaqëson një fushë strategjike për administratën e Biden-it dhe për të ardhmen e rajonit.

# KONTEKSTI

**Q**ë nga dekada e viteve 1990, dhe veçanërisht në sfondin e luftërave që çuan në shpërbërjen e Jugosllavisë komuniste, roli i Shteteve të Bashkuara ka qenë thelbësor për stabilizimin e rajonit, zgjidhjen e konflikteve dhe hapjen e rrugës për integrimi euro-atlantik të rajonit. SHBA-të luajtën rol jetik për pavarësinë e Kosovës dhe për mbajtjen e Bosnjës dhe Hercegovinës si shtet i unifikuar, si dhe kanë mbështetur rrugën e Kroacisë, Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut drejt anëtarësimit në NATO.

Ballkani Perëndimor, veçanërisht që nga vitet 1990, ka gëzuar mbështetje dhe angazhim dypartiak. Ndryshimet politike në administratat presidenciale në Uashington nuk kanë çuar në ndryshime domethënëse të politikave nga ana e Shteteve të Bashkuara. Kjo ka bërë që të jenë të shumtë ata në rajon që shohin një vizion më konsistent nga ana e Shteteve të Bashkuara për të ardhmen e Ballkanit Perëndimor, i përqendruar në nevojën për të sjellë paqe dhe stabilitet, për të forcuar demokracinë dhe për t'i sjellë vendet më afër integritit në BE dhe NATO. Në të njëjtën kohë, veprimet në Ballkan janë koordinuar me evropianët, dhe në shumë situata kur BE-ja dhe shtetet anëtare të saj kanë qenë të ngurtë ose të ngadalshëm në veprim, forca shtytëse ka ardhur nga Uashingtoni. Kjo ka qenë receta e zakonshme që është llogaritur si e mirëqenë në rajon. Por mjedisi ndërkombëtar gjithnjë në ndryshim dhe administrata apatike e Trump-it në Uashington kanë implikuar ndryshime të reja në këtë marrëdhënie, çka ka rezultuar në pikëpamje dhe veprime të ndryshme ndaj Ballkanit Perëndimor, veçanërisht në lehtësimin e procesit të normalizimit mes Kosovës dhe Serbisë. Përveç rolit aktiv në Kosovë, administrata e Trump-it luajti rol aktiv në finalizimin e anëtarësimit të Malit të Zi në NATO, duke mbështetur marrëveshjen e Prespës në Maqedoninë e Veriut që hapi rrugën drejt anëtarësimit në NATO,<sup>1</sup> dhe duke përshëndetur pa mëdyshje kalimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në një forcë ushtarake. Këto ishin arritje strategjike për Ballkanin Perëndimor që e kanë forcuar sferën euro-atlantike në rajon.

Roli i SHBA-ve gjatë administratës së Trump-it shihet kryesisht në Kosovë, i ndikuar nga të metat e vetë BE-së në avancimin e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë dhe vetë fakti që administrata e Trump-it ka pasur një qasje të ndryshme ndaj Evropës, ku ka pasur një mosbesim të thellë në bashkëpunim me BE-në. Kjo situatë kishte çuar në emërimin e një përfaqësuesi politik nga Shtëpia e Bardhë, ambasadorit Richard Grenell, dhe një anëtar të Shërbimit të Jashtëm nga Departamenti i Shtetit, Matthew Palmer, të dy përgjegjës për dialogun, por që nuk kishin shumë ndërveprim dhe besim.<sup>2</sup> Angazhimi amerikan gjatë kësaj periudhe kishte çuar në një mungesë koordinimi me BE-në dhe rezultoi në një krizë të ndërmjetësimit nga BE-ja, por edhe brenda Kosovës për shkak të spektrit të fragmentuar politik dhe polarizimit intensiv sidomos kundrejt dialogut me Serbinë. Teksa një pjesë e spektrit politik ishte në favor të ecjes përpara nën ndërmjetësimin amerikan edhe pse të udhëhequr nga ambasadori Grenell, nga ana tjetër ishte kryeministri i sapoemëruar Albin Kurti ai që preferonte më shumë një dialog brenda kornizës së BE-së. Qeveria e Kurtit u rrëzua në mars 2020, e perceptuar gjerësisht në publik si rezultat i “ndërhyrjes së Uashingtonit” për shkak të refuzimit të tij për

<sup>1</sup> Radio Evropa e Lirë. (27 mars 2020). Maqedonia e Veriut Anëtarësohet Zyrtarisht në NATO. Në dispozicion në: <https://www.rferl.org/a/north-macedonia-officially-joins-nato/30513509.html>

<sup>2</sup> Balkan Insight. (4 tetor 2019). Trump emëron një tjetër të dërguar të SHBA-ve në Ballkan. Në dispozicion në: <https://balkaninsight.com/2019/10/04/trump-appoints-another-us-envoy-to-balkans/>



t'u angazhuar me Ambasadorin Grenell. Gjithashtu, ndryshimet e shpeshta të qeverisë gjatë një viti e kanë zgjatur progresin në dialog dhe trajtimin e çështjeve të brendshme, përfshirë sfidën e pandemisë.

I dërguari presidencial amerikan Grenell ftoj më 27 qershor 2020 në Shtëpinë e Bardhë një samit në të cilin Presidenti i atëhershëm i Kosovës Hashim Thaçi dhe Kryeministri Avdullah Hoti do të duhej të takoheshin me Presidentin serb Aleksandër Vuçiq nën ndërmjetësimin e SHBA-ve. Ndërkohë që delegacionet ishin rrugës për në Uashington, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ngriti aktakuzë në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) kundër Presidentit të Kosovës Thaçi për krime lufte për kohën kur ai ishte udhëheqës politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) gjatë luftës së vitit 1999 kundër Serbisë.<sup>3</sup>

Më 4 shtator 2020 u mbajt një samit i ri-planifikuar në Shtëpinë e Bardhë, duke rezultuar në atë që delegacionet e Kosovës dhe Serbisë ranë dakord për atë që zakonisht quhet "zotimet e Uashingtonit për normalizimin ekonomik" si dy zotime të ndara nga Kosova dhe Serbia. Edhe pse qëllimi i samitit u pa kryesisht si një përpjekje nga ana e Shteteve të Bashkuara për të siguruar një marrëveshje njohjeje reciproke, Serbia nuk u pajtua, por administrata e Trump-it e përdori momentumin për të nxitur disa nga agjendat e tyre që synonin një angazhim më të madh amerikan në rajon dhe zvogëlimin e ndikimit rus dhe kinez përmes zotimeve që pranuan të dyja palët për projektet e energjisë, telekomunikacionit dhe infrastrukturës.<sup>4</sup> Samiti i Uashingtonit, me Presidentin Trump që priti nënshkrimin në Zyrën Ovale, shënoi një ndryshim të rëndësishëm në qasjen e Shteteve të Bashkuara drejt normalizimit të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë të lehtësuar nga Bashkimi Evropian që nga viti 2011, duke qenë se zyrtarët amerikanë kishin pjesëmarrje në 'hije' dhe shihesh-in sikur qëndronin në 'sfond'. Por kritikët e procesit të udhëhequr nga Richard Grenell e konsideruan kohën e takimit në Shtëpinë e Bardhë si pjesë e fushatës së rizgjedhjes së Presidentit Trump.<sup>5</sup> Pavarësisht kritikave për kohën dhe marrëveshjen që do të përdorej si një "trofe" në politikën e brendshme amerikane, takimi në Uashington e rifilloi procesin e udhëhequr nga Brukseli.<sup>6</sup>

Pothuajse një vit pas takimit në Uashington, skena politike në Shtetet e Bashkuara dhe në Kosovë duket ndryshe; Presidenti Joe Biden u betua vetëm një muaj para se Albin Kurti, një kritik i fortë i dialogut të normalizimit mes Kosovës dhe Serbisë të rizgjidhej si Kryeministër në shkurt të vitit 2021. Momentumi që solli Samiti i Uashingtonit filloi të zbehet. Me një skenë të re politike në Kosovë dhe në SHBA, pritshmëritë për administratën e re janë të larta në Kosovë, por edhe në vende të tjera të rajonit, ku ngërçi dhe pasiguria janë fjala kyçe në peisazhin politik.

<sup>3</sup> Zyra e Prokurorit të Specializuar. (24 qershor 2020). Deklaratë për shtyp. Në dispozicion në: <https://www.scp-ks.org/en/press-statement>

<sup>4</sup> Reuters. (15 shtator 2020). Trump lavdëron hapat ekonomikë mes Serbisë dhe Kosovës. Në dispozicion në: <https://www.reuters.com/article/usa-serbia-kosovo-int-idUSKBN25V2L>

<sup>5</sup> Intervistë, 16 prill 2021.

<sup>6</sup> Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm. (9 shtator 2020). Dialogu Beograd-Prishtinë: Deklaratë e përbashkët nga Presidenti A. Vuçiq dhe Kryeministri A. Hoti para takimit të tyre në Bruksel. Në dispozicion në: [https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/84787/belgrade-pristina-dialogue-joint-statement-president-avucic-and-prime-minister-ahoti-ahead\\_en](https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/84787/belgrade-pristina-dialogue-joint-statement-president-avucic-and-prime-minister-ahoti-ahead_en)

# QASJA E POLITIKËS SË JASHTME TË BIDEN-IT

Zyrtarët e administratës së Biden-it në shumicën e komunikimeve të tyre kanë përcjellë një mesazh që SHBA-të do të ri-angazhohen me aleatët dhe partnerët e tyre, duke i dhënë siguri Evropës se partneriteti transatlantik do të riparohet dhe se SHBA-të dhe Evropa do të punojnë së bashku për të adresuar sfidat në Evropë dhe më gjerë.<sup>7</sup> Politika e jashtme e administratës së Biden-it duket se është e fokusuar në një numër temash kyçe që do të parashtrijnë vlerat dhe parimet tradicionale amerikane, siç janë demokracia, të drejtat e njeriut dhe tregtia e lirë, dhe është e angazhuar për të punuar me aleatët dhe partnerët duke pasur besim në institucionet shumëpalëshe.<sup>8</sup> Një politikë e tillë e jashtme duket sigurose për aleatët e Amerikës, por sfidat janë më të mëdha se kurrë. Sot bota sfidohet nga një Kinë në rritje dhe më agresive, një krizë shëndetësore dhe pandemike që ka krijuar sfida për jetën e qytetarëve dhe ekonominë, ndërsa tendencat autoritare janë në rritje. Kjo ka bërë që shumë mekanizma shumëpalësh të jenë të dobët për adresimin e problemeve dhe risqeve aktuale. Për më tepër, kjo e sfidon edhe më shumë politikën e jashtme amerikane, dhe në muajt e ardhshëm mbetet për t'u parë sa hapësirë zënë Ballkani Perëndimor dhe Kosova në këtë mozaik temash, por si shenjë e fundit kundrejt rajonit nga Uashingtoni ka një ripozicionim rreth disa parime kyçe që përbëjnë qasjen e përgjithshme të politikës së jashtme të administratës së Biden-it.

Politika e jashtme e Presidentit Biden ndaj Ballkanit Perëndimor dhe çështjet kyçe në rajon do të përshtaten me këtë agjendë të gjerë globale që synon rivendosjen e udhëheqjes amerikane të shoqërisë ndërkombëtare. Siç kuptohet në Uashington, koordinimi me evropianët në Ballkanin Perëndimor është thelbësor për të bërë progres në rajon dhe duhet të trajtohen tërësisht çështjet kritike që janë një sfidë për demokratizimin, zhvillimin ekonomik dhe integrimin euroatlantik.<sup>9</sup> Pas diskutimeve të shtuara për ndryshimet e kufijve në rajon, që duket se janë projektuar drejt Bosnjës dhe Hercegovinës ku situata politike është më e brishtë se kudo në rajon, administrata e re ka riafirmuar qëndrimin e saj kundër ndryshimeve të kufijve në Ballkanin Perëndimor, çka përfaqëson një rikthim në konsensusin para vitit 2017 kur kjo çështje ishte një tabu dhe kuptimi i gjerë ishte se duhet të respektohet rendi politik i vendosur në rajon pas luftërave jugosllave.<sup>10</sup>

Administrata e Biden-it ka shumë gjasa të ketë nevojë të balancojë mes pritshmërive ndaj saj, trendeve dhe sfidave aktuale në rajon, dhe angazhimit të ngadalshëm evropian i cili tashmë ka dëmtuar kredibilitetin në rajon për shkak të bllokimit në procesin e zgjerimit në Ballkanin Perëndimor. Administrata ka treguar se prioritetet e saj në Ballkanin Perëndimor do të fokusohen në adresimin e një sërë çështjesh që sigurojnë që rajoni të ecë përpara, por edhe të përshtatet me sfidat e reja, të cilat nuk janë të njëjta me 20 vjet më parë kur rajoni ishte në tranzicion nga lufta. Sot, sfidat në rajon kanë të bëjnë më shumë me rënien e demokracisë,

7 Departamenti i Shtetit i SHBA-ve. (3 mars 2021). Një politikë e jashtme për popullin amerikan. Në dispozicion në: <https://www.state.gov/a-foreign-policy-for-the-american-people/>

8 Biden, Joe. 2020. Pse Amerika duhet të udhëheqë përsëri - shpëtimi i politikës së jashtme amerikane pas Trump-it. Foreign Affairs, mars/prill 2020, 99/2. fq. 64-72.

9 Intervistë, 21 prill 2021.

10 Departamenti i Shtetit i SHBA-ve. (26 prill 2021). Përkushtimi i SHBA-ve ndaj Ballkanit Perëndimor. Në dispozicion në: <https://www.state.gov/u-s-commitment-to-the-western-balkans/>

sfidën e rëndë të korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe paqëndrueshmërinë për shkak të pamundësisë për t'i zgjidhur dhe trajtuar çështjet e hapura politike në rajon, dhe të gjitha këto e bëjnë të pamundur të ecet përpara me integrimin evropian dhe zhvillimin ekonomik.

Veprimet e fundit të Shtëpisë së Bardhë të Biden-it dhe Departamentit të Shtetit kanë treguar se qasja e tyre është të adresojnë çështjet thelbësore që e mbajnë Ballkanin Perëndimor në ngërç. Shumë nga çështjet strategjike në rajon kërkojnë bashkëpunim me evropianët, në mënyrë që të përshpejtohet procesi i integritit evropian që duhet të shoqërohet me progresin e mundshëm. Do të jetë shumë e vështirë të bëhet progres i kënaqshëm nëse qasja e administratës së Biden-it nuk gjen mbështetjen e nevojshme në Bashkimin Evropian, dhe kjo kërkon progres dhe shpejtësi më të madhe brenda Bashkimit Evropian për të zhbllokuar procesin e integritit evropian.

# NGËRÇI KOSOVË-SERBI

**D**ialogu për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë ishte çështja më e theksuar nga Ballkani Perëndimor për administratën e Trump-it. Administrata e Biden-it pritet të luajë rol aktiv dhe mesazhet që janë dërguar deri më tani nga administrata e re përmes letrave të Presidentit Biden dhe Sekretarit Blinken drejtuar udhëheqësve të Kosovës dhe Serbisë shprehin gatishmërinë për të adresuar çështjen kyçe në procesin e normalizimit, atë të njohjes reciproke.<sup>11</sup> Presidenti Trump u bë lideri i parë perëndimor që kërkoi nga Serbia njohjen e Kosovës zyrtarisht, dhe sot kjo politikë rikonfirmohet nga Presidenti Biden, duke treguar kështu një konsensus dypartiak në Uashington për njohjen e Kosovës nga Serbia. Nga pikëpamja amerikane, Kosova dhe Serbia duhet të arrijnë një marrëveshje të përhershme që do të adresonte çështjet e hapura mes dy vendeve, të cilat duhet të përqendrohen në njohjen reciproke.

Shtetet e Bashkuara janë një fuqi në Evropë, janë motori që e lëviz Evropën në çështjet kyçe ndërkombëtare, dhe kjo ka qenë historia e Kosovës gjatë dekadave të fundit. Por me sfidat ndërkombëtare në rritje dhe skenën ndërkombëtare gjithnjë në ndryshim, nuk pati një angazhim linear nga Uashingtoni. Administrata e Obama-s e neglizhoi Evropën duke ia lënë kështu dialogun Kosovë-Serbi kryesisht lehtësimit të BE-së, ndërsa administrata e Trump-it e injoroi tërësisht Evropën por u angazhua në Kosovë - kinse për përfitime të brendshme politike - dhe kjo ndikoi në dinamikën e dialogut Kosovë-Serbi. Nëse shihen fjalët e administratës së Biden-it, ajo dëshiron të angazhohet së bashku me evropianët, por ajo duhet t'i shohë marrëdhënien Kosovë-Serbi ashtu siç janë, çështja më delikate në rajon, dhe duhet që roli i SHBA-ve të përmbillet me sukses.

Qasja e vendosur nga administrata e Biden-it për politikën e saj të jashtme jep siguri se do të ketë një partneritet me BE-në për lehtësimin, duke e mbështetur procesin e udhëhequr nga BE-ja në dia-log, dhe se do të ketë vazhdimësi në temat dhe parimet e formuluar vite më parë. Në një kohë kur sfidat globale janë të mëdha, G7 në takimin e ministrave të jashtëm në Londër e kishte bërë një prej çështjeve kyçe Ballkanin Perëndimor dhe rëndësinë e dialogut. G7 i bëri thirrje Kosovës dhe Serbisë që të angazhohen në mënyrë konstruktive në negociatën në kornizën e dialogut të lehtësuar nga BE-ja dhe t'i normalizojnë plotësisht marrëdhëniet e tyre përmes një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht detyruese, ndërsa zërat që bënë thirrje për ndryshimin e kufijve në rajon u kundërshtuan ashpër.<sup>12</sup>

Administrata e Biden-it e ka mbështetur Marrëveshjen e Uashingtonit për Normalizimin Ekonomik të shtatorit 2020, duke i dalë kundër deklaratave të Kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, i cili ka shprehur kundërshtimin dhe ngurrimin për ta zbatuar atë.<sup>13</sup> Teksa ka vend për zbatimin e shumë elementeve, veçanërisht ato që lidhen me projektet e investimeve, pavarësinë më të madhe nga Rusia në sektorin e energjisë dhe nga Kina në rrjetin 5G, qeveria

11 Zëri i Amerikës. (24 shkurt 2021). Duke folur mbi mosmarrëveshjen e gjatë Serbi-Kosovë, Biden sinjalizon interesin për Evropën. Në dispozicion në: <https://www.voanews.com/usa/weighing-long-running-serbia-kosovo-dispute-biden-signals-interest-europe>

12 Zyra e Jashtme, e Komonuelthit dhe Zhvillimit. (5 maj 2021). Takimi i Ministrave të Jashtëm dhe të Zhvillimit të G7: Komunikatë, Londër, 5 maj 2021. Në dispozicion në: <https://www.gov.uk/government/publications/g7-foreign-and-development-ministers-meeting-may-2021-communicate/g7-foreign-and-development-ministers-meeting-communicate-london-5-may-2021>

13 Departamenti i Shtetit i SHBA-ve. (26 prill 2021). Përkushtimi i SHBA-ve ndaj Ballkanit Perëndimor. Në dispozicion në: <https://www.state.gov/u-s-commitment-to-the-western-balkans/>

e Kosovës duhet të gjejë një gjuhë të përbashkët për temat që lidhen me integrimin e saj ndërkombëtar, konkretisht procesin e njohjes dhe anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare. Gjatë administratës së Obama-s pati mbështetje për dialogun e lehtësuar nga BE-ja, por edhe për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare dhe njohjen e shtetësisë së saj nga vendet e treta, ku ka pasur dhjetëra rezultate. Një pajtueshmëri e tillë duhet të gjendet përsëri para se të për-fundojë periudha njëvjeçare në shtator në moratoriumin për të mos aplikuar në organizatat ndërkombëtare (Kosova) dhe për të mos u përfshirë në procesin e çnjohjes (Serbia). Përndryshe, vendosja e një moratoriumi pa afat në politikën e jashtme të Kosovës nuk shkon në interesin e Kosovës dhe as të Shteteve të Bashkuara, pasi i jep Beogradit të drejtën e vetos mbi integrimin e Kosovës në bashkësinë ndërkombëtare.

Nga ana tjetër, duhet gjetur mënyra për ta parandaluar Beogradin nga tërheqja e njohjes së Kosovës, dhe forma më e mirë është politika e sanksioneve të SHBA-ve dhe BE-së, sepse pozicioni i vendeve të treta nuk duhet të jetë peng i rezistencës së Beogradit për t'u pajtuar me Kosovën. Ngurrimi i BE-së dhe SHBA-ve gjatë viteve 2017-2019 për të adresuar siç duhet fushatën e çnjohjes së Serbisë çoi në situatën që Kosova duhej të vendoste tarifa tregtare ndaj Serbisë si reagim i fundit ndaj asaj që në Kosovë shihet si sulm i drejtpërdrejtë nga Serbia mbi pavarësinë dhe sovranitetin e saj.<sup>14</sup> Është e nevojshme të kuptohet se si SHBA-të dhe BE-ja mund të ndikojnë tek Serbia dhe veprimet e saj.

Në lidhje me rolin e Shteteve të Bashkuara në dialogun e normalizimit mes Kosovës dhe Serbisë, administrata e Biden-it duket se është e fokusuar në kthimin në rolin mbështetës për BE-në që ishte përqafuar gjatë administratës së Obama-s. Në atë kohë, logjika pas kësaj formule ishte se Kosova nuk duhet të jetë një temë në të cilën kërkojnë përfshirje vende si Rusia, për çka Beogradi ka këmbëngulur për mjaft kohë.<sup>15</sup> Kjo i mundësoi administratës së Obama-s të angazhohet në rajone të tjera dhe që çështjet e Ballkanit Perëndimor të jenë brenda kornizës euro-atlantike ku duhet të zgjidhen problemet. Sidoqoftë, kjo nuk pasqyron të tashmen. Zgjerimi evropian ka ngecur në rajon, nuk ka shumë mbështetje brenda BE-së për politikën e zgjerimit, ndërsa në Kosovë frustrimi me moslejimin e lëvizjes së lirë në zonën Schengen, pavarësisht përmbushjes së të gjitha kriterëve, e ka diskredituar rëndë kredibilitetin e BE-së. Kjo duket të jetë arsyeja pse, për sa kohë që BE-ja mbështetet në rolin e saj, i është përkujtuar në komunikatat e G7 dhe Departamentit të Shtetit se politika e zgjerimit mbetet një stimul thelbësor për të arritur progres në rajon. Vetë zyrtarët amerikanë kanë lobuar në shumë raste në kryeqytetet evropiane për të dhënë liberalizimin e vizave për Kosovën ose për hapjen e negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë.<sup>16</sup>

Administrata e Biden-it do të luajë një rol mbështetës për BE-në në procesin e dialogut. Mesazhet e ndryshme të përcjella në Prishtinë dhe Beograd janë dëshmi e një gatishmërie të tillë. Por kjo nuk do të jetë e mjaftueshme për të ecur përpara. Duket se ka pak gjasa që çështjes së Kosovës t'i kushtohet shumë vëmendje nga niveli më i lartë i administratës, dhe ndryshe nga administrata e Trump-it, nuk është e qartë nëse do të emërohet një i dërguar special, gjë që mbetet për t'u parë më vonë sepse emërimi dhe konfirmimi i zyrtarëve të lartë kanë ecur ngadalë në Uashington. Dialogu Kosovë-Serbi nuk është mes çështjeve kryesore të politikës së jashtme të nivelit më të lartë në Uashington.<sup>17</sup> Një i dërguar i posaçëm do të ishte një ndërhyrje e rëndësishme nga Uashingtoni për t'i ndihmuar BE-së në lehtësimin e

14 Visoka. Gëzim. (12 dhjetor 2018). Nga çnjohja në vetënjohje. Sbunker. Në dispozicion: <https://sbunker.net/osf-alumni/89803/nga-çnjohja-ne-vetenjohje/>

15 Intervistë, 4 maj 2021.

16 Intervistë, 4 maj 2021.

17 Intervistë, 1 maj 2021.

dialogut dhe ndërmarrjen e diplomacisë direkte me Kosovën dhe Serbinë për çështjet dhe në momentet kur BE-ja ngec, por ka shumë të gjasa që emërimi i një të dërguari të tillë të ndikohet nga gatishmëria e të dyja palëve për t'u angazhuar ose jo në dialog dhe për t'u pajtuar për një marrëveshje. I dërguari e posaçëm i BE-së Miroslav Lajčák u shoqërua nga Zëvendës Ndihmës Sekretari Amerikan i Shtetit Matthew Palmer në vizitën e tij të fundit në Prishtinë dhe Beograd, një sinjal i cili mund të ndihmojë veçanërisht në Kosovë, ku lidhshipi amerikan ka ndikim dhe mund ta trajtojë stagnimin, përndryshe, BE-ja e vetme nuk do të jetë një fuqi e politikës së jashtme e aftë për të ushtruar ndikim.<sup>18</sup> Vizita e fundit e përbashkët nga Zëvendës Ndihmës Sekretari Amerikan i Shtetit, Matthew Palmer, dhe Përfaqësuesi i Bashkimit Evropian për Dialogun, Miroslav Lajčák, ua ka rikujtuar Kosovës dhe Serbisë se ka një koordinim të përbashkët mes SHBA-ve dhe BE-së për dialogun.

Është përgjegjësi e Kosovës që të jetë e zëshme në artikullimin e pritjeve dhe qëllimeve të saj duke pasur parasysh se ajo është subjekti kryesor në dialog. Teksa është pothuajse përtej dyshimit të arsyeshëm që Serbia nuk ka interes të arrijë një marrëveshje me Kosovën në të ardhmen e afërt, Kosova vetë duhet ta ndryshojë narrativën e saj kundrejt dialogut. Për sa kohë ka mesazhe mbështetëse nga SHBA-të dhe BE-ja për rifillimin e dialogut, Kosova duhet të rreshtohet në këtë drejtim. Qeveria e Kosovës duhet të formulojë politika të qarta që e bëjnë atë partner në dialog dhe të shmangë situatat në të cilat mund të fajësohet për bllokimin ose dështimin e procesit të dialogut. Ka disa zëra në BE që mendojnë se dialogu duhet të arrijë në përfundim, edhe me idenë se mund të konsiderohet i dështuar, dhe të sqarojë se cila palë është fajtorë dhe cila ishte bashkëpunuese.<sup>19</sup> Në të njëjtën kohë, ekziston një tendencë në rritje në mesin e disa shteteve anëtare të BE-së që Serbia të mos mbahet peng në procesin e integritimit në BE për shkak të Kosovës nëse kjo e fundit është shkak i bllokadës ose dështimit në dialog.<sup>20</sup> Kjo situatë nuk i përshtatet Kosovës dhe qeveria e Kosovës duhet të zbatojë një strategji më kreative në procesin e dialogut.

Një shtysë e madhe për një marrëveshje mes Kosovës dhe Serbisë do të ishin lëvizjet drejt një bashkëpunimi më të madh ekonomik rajonal në Ballkanin Perëndimor, nëse përdoret siç duhet nga Uashingtoni dhe Brukseli, ku vendet e rajonit do të kishin një treg të përbashkët. Si një ide ekonomike, kjo mund ta ndihmojë rajonin për më shumë hapje për investime dhe tregti, por kjo ide duhet të kthehet në një momentum të ri politik për rajonin dhe BE-në, për t'u përdorur si një model për anëtarësimin në bllok në BE. Një pikëpamjeje të tillë po i bën jehonë qeveria e Kosovës që synon të përfitojë nga një treg potencial i përbashkët i modeluar sipas Marrëveshjes aktuale EFTA-EEA për të kaluar në anëtarësimin në bllok në BE duke i përgatitur ekonominë dhe duke ndërmarrë reforma politike dhe ligjore.<sup>21</sup> Realiteti është se duhet guxim politik për të gjetur një mënyrë për ta çuar përpara integritimin evropian, dhe modelet dhe praktikët e deritanishme janë treguar joefektive dhe të ngadalta për shkak të burokracisë së tepërt që është instaluar në proces nga vetë shtetet anëtare të BE-së me qëllim që të ngadalësohet integritimi. Ky model mund të jetë edhe një opsion kreativ për të adresuar një marrëveshje të mundshme mes Kosovës dhe Serbisë duke ofruar stimujt e nevojshëm ndaj palëve për progresin e mundshëm. Por krijimi i një tregu të përbashkët rajonal ku nuk ka njohje reciproke mes Kosovës dhe Serbisë dhe asnjë lidhje me procesin e integritimit evropian ku të gjitha palët mund të hyjnë në BE së bashku, do ta komplikonte më tej situatën

18 Radio Evropa e Lirë/Radio Liria (REL/RL). (1 qershor 2021). Të dërguarit kryesorë të SHBA-ve dhe BE-së i thonë Kosovës se lidhjet më të mira me Serbinë do t'i hapin derën për Evropë. Në dispozicion në: <https://www.rferl.org/a/serbia-kosovo-normalization-palmer-lajcak/31284455.html>

19 Intervistë, 22 prill 2021.

20 Intervistë, 22 prill 2021.

21 Zyra e Kryeministrit të Kosovës. (10 qershor 2021). Kryeministri Kurti në Samitin e Tiranës: Kosova nuk mund të përfshihet në iniciativë që janë përshtatur për t'i mohuar shtetësinë, ne do të angazhohemi vetëm si të barabartë. Në dispozicion në: <https://kryeministri.rks.gov.net/en/speech-of-prime-minister-kurti-in-tirana-at-the-summit-of-the-six-western-balkans-states-2/>

në rajon. Qeveria e Kosovës me të drejtë ka treguar ngurrim, sepse iniciativa të tilla pa adresuar mosmarrëveshjet kyçe politike do ta mbanin peng Kosovën, dhe tregu i përbashkët nuk do të ishte efektiv pa adresuar pengesat politike në bashkëpunimin rajonal.

Me këtë administratë të re, përvojën e gjatë të Joe Biden me Kosovën, dhe angazhimit të tij në rajon për më shumë se tre dekada, periudha vijuese është vendimtare për Kosovën që të arrijë një marrëveshje përfundimtare në dialogun me Serbinë. Perspektiva gjeopolitike në botë nuk është në anën e Kosovës. Është një moment vendimtar që, nën lehtësimin evropian dhe mbështetjen amerikane, të arrihet në përfundimin mbi çështjen kyçe që e mbajnë peng sot bashkëpunimin rajonal dhe progresin e Kosovës dhe Serbisë drejt integritimit evropian.

Mbi të gjitha, është e nevojshme të kuptohet pozicioni i Kosovës, se në rrethanat aktuale maksimumi që mund të arrihet është të zhbllokohet procesi i anëtarësimit në NATO dhe të merret statusi i kandidatit nga BE duke arritur një marrëveshje me Serbinë dhe, si rezultat, njohjen nga 5 shtetet anëtare të BE-së: prandaj lidhshipi amerikan dhe garancitë e tij janë thelbësore në NATO. Dialogu nuk ka gjasa t'i ofrojë Kosovës një vend në OKB, të paktën jo menjëherë, për shkak të kërcënimeve ruse dhe potencialisht kineze për veto. Megjithatë, një marrëveshje mund të lehtësojë njohjen ndërkombëtare të Kosovës dhe anëtarësimin në të gjitha organizatat ndërkombëtare ku Rusia dhe Kina nuk kanë të drejta të vetos. Marrëdhëniet e SHBA-ve me Rusinë dhe Kinën pa dyshim do të ndikojnë në rrugën e Kosovës drejt OKB-së. Por ka përfitime për të dy vendet nga dialogu që duhet të komunikohen nga Uashingtoni dhe Brukseli në Kosovë dhe Serbi.

Një bllokadë në rrugën e të dy vendeve drejt BE-së dhe rrugës së Kosovës drejt NATO-s (siç është tani), nënkupton pasoja të rënda në fushat e brendshme si zhvillimi ekonomik, sundimi i ligjit dhe migrimi i të rinjve, por më shumë se kaq shkon në dobi të Rusisë dhe veglave të saj në rajon. Në të njëjtën kohë, është thelbësore që përveç kundërshtimit të ndryshimeve të kufijve në rajon, administrata e Biden-it të transmetojë mesazhe të qarta se ajo që Kosova ka pranuar me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (Plani i Ahtisaarit) është kompromisi përfundimtar nga Kosova dhe se çdo marrëveshje duhet të bëhet brenda asaj kornize. Përndryshe, hapja e Planit të Ahtisaarit rrezikon funksionimin e shtetit të Kosovës dhe stabilitetin e tij në planin afatgjatë. Një Kosovë jofunksionale nuk do të ishte përgjigja e duhur ndaj stagnimit aktual. Të dyja janë të rrezikshme për të ardhmen e Kosovës dhe të rajonit.

Por ka nevojë për një diskutim serioz mes Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara dhe partnerëve evropianë për rrugën përpara nëse dialogu nuk prodhon ndonjë rezultat ose vazhdon të ngeçë. Risku i konfliktit të ngrirë është serioz dhe i rrezikshëm, kështu që ka nevojë për një plan B. Duhet të ketë një qëllim të ndërmjetëm që parandalon izolimin e Kosovës. Dialogu është i rëndësishëm, por një ngërç në dialog nuk mund t'ia kalojë rëndësisë së integritetit të Kosovës në bashkësinë ndërkombëtare. Kosova është dëmtuar më së shumti vitet e fundit nga ngërçi në procesin e dialogut, prandaj kjo situatë nuk mund të vazhdojë pafund. Kështu, është strategjikisht e rëndësishme që Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian së bashku me qeverinë e Kosovës të dalin me një plan B nëse dialogu nuk arrin të përfundojë, por kjo do të kërkojë nga qeveria e Kosovës edhe një strategji konkrete dhe realiste se si të integrohet komuniteti serb që jeton në Kosovë, veçanërisht në komunat veriore të Kosovës.

# NYJA BOSHNJAKE

**B**osnja dhe Hercegovina është sfiduar të sigurojë funksionimin efektiv të sistemit shtetëror për shkak të mënyrës se si u ndërtua sistemi politik nga Marrëveshjet e Paqes të Dejtonit. Marrëveshja e Dejtonit ishte vërtet e fokusuar me ndalimin e luftës dhe jo me shmangien e tipareve që çonin në mosfunksionim. Kohët e fundit, në BeH retorika nacionaliste mes komuniteteve është në kulmin e saj dhe tendencat për shpërbërje të Republika Srpska po rriten nën udhëheqjen e Milorad Dodik-ut. BeH aktualisht nuk është në gjendje t'u përgjigjet nevojave të qytetarëve të saj dhe demokracia është ngulfatur rëndë nga ndarjet etnike në sistemin politik, ku më të prekurat janë pakicat që nuk i përkasin tre komuniteteve të mëdha: boshnjakët, serbët dhe kroatët. Në të njëjtën kohë, polarizimi i thellë ndëretnik dhe politik ka shkaktuar bllokada institucionale në nivelin qendror dhe lokal. Zgjidhja e këtyre sfidave politike që mbajnë peng progresin ekonomik të vendit dhe integrimin në NATO dhe BE nuk do të mund të kapërcehen shpejt dhe pa ndërhyrje në vetë sistemin politik. Por kjo mbetet peng i vetos së tre komuniteteve kryesore në vend.

Ndryshe nga Kosova ku ekziston një strukturë e caktuar e angazhimit ndërkombëtar për të adresuar çështjet me Serbinë, në BeH nuk ka vëmendje të veçantë nga BE-ja, dhe nuk kishte as nga SHBA-të gjatë epokës së Trump-it. Institucioni i Përfaqësuesit të Lartë Ndërkombëtar shihet si i rëndësishëm, por në praktikë, PLN është tërhequr në një rol vëzhguesi, pavarësisht se është ende i pajisur me fuqinë për të ndikuar drejtpërdrejt në proceset vendimmarrëse në vend. Bosnja është një nje sfiduese për t'u adresuar. Sfidat me të cilat përballlet vendi, përveç atyre të politikës së brendshme, ndikohen gjithashtu nga gjeopolitika e re e Ballkanit, ku ka një rritje të angazhimit rus në Republikën Srpska, dhe që duket të jetë pengesa kyçe për Perëndimin në çdo përpjekje për reforma në BeH.

BeH ka marrë më shumë vëmendje nga Perëndimi, si rezultat i retorikës gjithnjë e më përçarëse dhe veprimeve nga nacionalistët si Milorad Dodik, anëtari serb i Presidencës së Bosnjës dhe Hercegovinës. Veç kësaj, emërimi i Christian Schmidt nga Gjermania si Përfaqësuesi i ri i Lartë Ndërkombëtar dhe qarkullimi i të ashtuquajturës "non-paper sloven"- që u mohua nga Sllovenia si burim i këtij dokumenti - e cila bëri thirrje për një ndryshim të kufijve në Ballkanin Perëndimor, tregon se ka një interes të përtërirë nga bashkësia ndërkombëtare për skenarët e mundshëm mbi të ardhmen e BeH-së.<sup>22</sup> Emërimi i Përfaqësuesit të ri të Lartë Ndërkombëtar ka ndezur polemika në Bosnjë, kryesisht për shkak të risqeve që Republika Srpska me mbështetjen e Beogradit dhe Moskës do të krijojë një krizë për të testuar aftësinë dhe gatishmërinë e Schmidt-it për të vepruar kundër atyre që pengojnë Marrëveshjen e Dejtonit. Kritikët argumentojnë me të drejtë se PLN në largim, Valentin Inzko, i cili ka qenë në detyrë për më shumë se një dekadë, nuk ka qenë problem në mandatin e tij ose i mun-gontë vullneti për të vepruar, por atij i mungontë vullneti politik dhe mbështetja nga Komuniteti Ndërkombëtar për ta përdorur fuqinë politike të Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë Ndërkombëtar brenda sistemit politik të Bosnjës për të adresuar pengesat nga Banja Luka.<sup>23</sup>

<sup>22</sup>Radio Evropa e Lirë/Radio Liria (REL/RL). (29 prill 2021). 'Paper-i fantazmë' që askush në Ballkanin Perëndimor nuk pranon se e ka shkruar. Në dispozicion në: <https://www.rferl.org/a/non-papers-phantom-brussels-kosovo-serbia-bosnia-slovenia/31229431.html>  
<sup>23</sup> Sevdik, Senad. (7 prill 2021). Kandidati i Gjermanisë për Përfaqësues të Lartë në BeH, Christian Schmidt, dhe përdorimi i mundshëm prej tij i kompetencave të Bonit. Qendra për Studime Euroaziatike. Në dispozicion në: <https://avim.org.tr/Blog/GERMANY-S-HIGH-REPRESENTATIVE-CANDIDATE-IN-BIH-CHRISTIAN-SCHMIDT-AND-HIS-POSSIBLE-USE-OF-BONN-POW->



Përkundër kritikave ndaj Christian Schmidt në BeH, G7, përfshirë Shtetet e Bashkuara, e kanë mbështetur nominimin e tij.<sup>24</sup> Kundërshtimi i emërimit të Schmidt-it nuk ka ardhur vetëm nga pala boshnjake<sup>25</sup>, zërat kundërshtues kanë ardhur edhe nga Republika Srpska, duke bërë thirrje për mbylljen e Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë Ndërkombëtar.<sup>26</sup> Arsyeja pse ekziston një kundërshtim ndaj pranisë ndërkombëtare në pjesën e Republikës Srpska lidhet kryesisht me mandatin që gëzon kjo Zyrë për të ndërhyrë në situatat kur sfidohet marrëveshja e Dejtonit, dhe sfida ndaj Dejtonit sot vjen kryesisht nga Milorad Dodik dhe prirjet e tij për ndarje, duke e përdorur shpesh në muajt e fundit termin “ndarje paqësore e BeH”, çka nxit një kthim në retorikën ultra-nacionaliste të viteve 1990 nga udhëheqësit e serbëve të Bosnjës.<sup>27</sup> Dodik konsideron se emërimi i Përfaqësuesit të ri të Lartë Ndërkombëtar është në kundërshtim me vetë Marrëveshjet e Dejtonit, e cila kërkon marrëveshjen e dy njësive në BeH, Republika Srpska dhe Federatës së Bosnjë dhe Hercegovinës, dhe mbi këto baza ai dhe parlamenti i Republika Srpska kanë paralajmëruar se do ta sfidojnë emërimin. Një sfidim i tillë nuk është vetëm një sfidë për emërimin e një individi, por sfida e parë që mund të vijë nga Dodik ndaj unitetit të BeH dhe rendit politik të vendosur nga Dejtoni, i cili pavarësisht sa jofunksional ka shërbyer për të ruajtur paqen mes grupeve etnike në vend. Aftësia e Përfaqësuesit të ri të Lartë Ndërkombëtar për ta zgjeruar ndikimin dhe autoritetin e tij do të varet shumë nga mbështetja e SHBA-ve, dhe një mbështetje e tillë do të jetë jetike për të ardhmen e BeH.

Ka shenja të qarta që tregojnë një përfshirje shumë më të drejtpërdrejtë amerikane në BeH që synon të çojë përpara reformat kushtetuese dhe të ruajë sovranitetin dhe integritetin territorial të BeH. Sekretari amerikan i Shtetit Anthony Blinken i ka dërguar një mesazh të qartë Presidencës trepalëshe të BeH se nevojiten reforma të kufizuara kushtetuese për të ardhmen e vendit, por në krahasim me të kaluarën, qeveria amerikane nuk duket të jetë e interesuar për reforma drastike, por disa veprime që e bëjnë BeH një shtet më funksional sesa është tani.<sup>28</sup> Reformat që synojnë ta bëjnë BeH më të centralizuar nuk do të mbështeten nga serbët, ndërsa më shumë decentralizim ndaj dy njësive pa më shumë demokratizim të BeH dhe instalimi i një elite politike më shumë të orientuar nga qytetarët sesa grupet etnike nuk do të ndihmojnë në adresimin e sfidave të BeH.<sup>29</sup> Uashingtoni mbetet të jetë më i qartë për qëllimin e vet në BeH dhe të sigurojë mbështetje më të gjerë, duke përfshirë që Serbia dhe Kroacia të bëhen më konstruktive në çështjet e Bosnjës. Sfida e parë është të sigurohet që Schmidt të marrë detyrën dhe do të jetë mbështetës për një përpjekje të reformës kushtetuese të udhëhequr nga SHBA, çka përfundimisht mund të sigurojë zgjedhje të përgjithshme të qeta të vitit 2022, të cilat kërcënohen me bojkot nga linjat e ashpra serbe dhe kroate. Bosnja, ashtu si Kosova, do të jetë një test vendimtar për koordinimin SHBA-BE në Ballkanin Perëndimor.

[ERS-07-04-2021?](#)

24 Zyra e Jashtme, e Komonuelthit dhe Zhvillimit. (5 maj 2021). Takimi i Ministrave të Jashtëm dhe të Zhvillimit të G7: Komunikatë, Londër, 5 maj 2021. Në dispozicion në: <https://www.gov.uk/government/publications/g7-foreign-and-development-ministers-meeting-may-2021-communicue/g7-foreign-and-development-ministers-meeting-communicue-london-5-may-2021>

25 Intervistë, 29 prill 2021.

26 Balkan Insight. (1 mars 2021). Parlamenti serb i Bosnjës i thotë ‘Jo’ Përfaqësuesit të ri të Lartë. Në dispozicion në: <https://balkaninsight.com/2021/03/10/bosnian-serb-parliament-says-no-to-new-high-representative/>

27 Balkan Insight. (1 mars 2021). Parlamenti serb i Bosnjës i thotë ‘Jo’ Përfaqësuesit të ri të Lartë. Në dispozicion në: <https://balkaninsight.com/2021/03/10/bosnian-serb-parliament-says-no-to-new-high-representative/>

28 TRT World. (1 prill 2021). SHBA bën thirrje për ndryshime në kushtetutën e Bosnjës. Në dispozicion në: <https://www.trtworld.com/europe/us-calls-for-changes-to-bosnia-s-constitution-45528>

Intervistë, 14 prill 2021.

# RUSIA DHE KINA NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Sot mjedisi në rajon është më i sfiduar se kurrë më parë nga akterët malinj. Ndikimi kinez dhe rus në Ballkanin Perëndimor është rritur që kur Presidenti Biden ishte pjesë e administratës së Presidentit Obama. Këtu kanë kontribuar shumë faktorë, si rënia politike por edhe ekonomike në rajon, veçanërisht me nënvlerësimin e ndikimit kinez që vetëm vitet e fundit gjatë administratës së Trump-it ka filluar të kuptohet ndryshe në botë dhe në Ballkanin Perëndimor në mënyrë më specifike. Nëse Rusia është mot i keq për rajonin, atëherë Kina është ndryshim klimatik, dhe të dyja janë sfidues të rendit aktual politik dhe ekonomik.

Rusia vazhdon të jetë një kërcënim më i drejtpërdrejtë politik dhe i sigurisë për rajonin përmes ndikimit të saj në Serbi dhe në entitetin e Republikës Srpska në të gjithë sektorët, dhe me veprimet e saj në vitet e fundit, përfshirë grushtin e shtetit të vitit 2016 në Mal të Zi, pengimi i integritetit ndërkombëtar të Kosovës, ose madje edhe ndërhyrjet për të kundërshtuar anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO.<sup>30</sup> Këto veprime janë bërë për të sfiduar udhëheqjen amerikane në rajon, por edhe integritetin e këtyre vendeve në BE dhe NATO. Është në interesin e vetë Rusisë që rajoni të mbetet në stagnim, dhe ajo është akteri i vetëm që mund të përfitojë nga mungesa e zgjidhjes në marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë, nga mbajtja peng e së ardhmes së Bosnjës dhe autoritarizmi në rritje në Serbi. Në këto tre vende, Rusia sheh një zonë që duhet lënë jashtë NATO-s; teksa Serbia nuk ka qëllime të tilla për anëtarësim, në Kosovë dhe pjesërisht në BeH ka mbështetje të lartë për anëtarësim, dhe veprimet ruse do të jenë për të parandaluar një zgjerim të mëtejshëm të NATO-s në rajon.<sup>31</sup> Kjo është arsyeja pse trajtimi i çështjeve politike në rajon nga administrata e Biden-it duhet të lidhet me ofrimin e një perspektive të qartë të anëtarësimin në NATO për Kosovën dhe BeH.

Angazhimi kinez në rajon ndryshon nga ai i Rusisë, por ato nuk janë përjashtues në qëllim. Teksa roli i Rusisë është shumë i kufizuar në ekonomi dhe kryesisht në Serbi dhe Republika Srpska, dhe më i madh përmes ndërhyrjeve politike dhe të sigurisë, roli i Kinës është kryesisht në ekonominë e rajonit dhe infrastrukturën jetike. Politika e administratës së Biden-it ndaj angazhimit kinez në rajon do të ndikohet shumë nga qasja e përgjithshme e Uashingtonit ndaj rolit kinez në botë. Uashingtoni synon të punojë me aleatët në Evropë dhe më gjerë për t'iu kundërvënë rritjes së rolit të Kinës dhe për të konkurruar strategjikisht me Kinën, gjë që do të kufizonte ndikimin e saj në shumë rajone, përfshirë Ballkanin.<sup>32</sup> Akti i Konkurrencës Strategjike i vitit 2021, një nismë dypartiake e Senatit, nuk ka ndonjë referencë specifike për Ballkanin Perëndimor, por adreson çështjet e partneritetit me Evropën në kuadër të temave kyçe brenda Evropës që do të kufizonin ndikimin kinez.<sup>33</sup>

Roli i Kinës në rajon është rritur ndjeshëm në Serbi, ku nga perspektiva e Kinës Serbia sot përfaqëson aleatin e saj më të ngushtë në Evropë, ndërsa me vende të tjera si Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe BeH ajo ka përfshirje në projekte të ndryshme ekonomike dhe

30 Haddad, Aya-Nay. (19 prill 2021). Ballkani Perëndimor: Kina dhe Rusia fitojnë pikë. Qendra për Analizën e Politikave Evropiane-CEPA. Në dispozicion në: <https://cepa.org/the-western-balkans-china-and-russia-steal-a-march/>

31 Intervistë, 7 maj 2021

32 Intervistë, 7 maj 2021

33 Kongresi i SHBA-ve. (7 maj 2021). Një ligj për të adresuar çështjet që përfshijnë Republikën Popullore të Kinës. Në dispozicion në: <https://www.foreign.senate.gov/imo/media/doc/DAV21598%20-%20Strategic%20Competition%20Act%20of%202021.pdf>

infrastrukturore. Por angazhimi në Ballkan nuk është si një platformë e unifikuar rajonale, por më shumë në nivelin dypalësh dhe në disa mënyra edhe përmes nismës 17+1 mes Evropës Qendrore dhe Kinës. Për Kinën, Ballkani Perëndimor është i rëndësishëm për shkak të afërsisë me BE-në dhe mund të shërbejë si një qendër e rëndësishme tregtare.<sup>34</sup> Për Shtetet e Bashkuara dhe BE-në, Kina do të jetë një rival strategjik dhe sistematik në Ballkanin Perëndimor, duke synuar ta shohë rajonin si një enklavë në Evropë, ku ajo do të vazhdojë të rrisë praninë e saj.<sup>35</sup>

Kriza e borxhit kinez në Mal të Zi ka treguar se financimi kinez nuk është vetëm i pashëndetshëm për qëndrueshmërinë ekonomike dhe politike, por edhe për buxhetin e vendeve të rajonit. Në shumë raste, projektet e shpallura në bashkëpunim me Kinën nga qeveritë rajonale nuk janë zbatuar, ose në disa të tjera kanë provokuar kundërshtime lokale. Gjatë administratës së Trump-it, Korporata Financiare për Zhvillim tregoi interes për rajonin, çka ishte gjithashtu pjesë e Marrëveshjes së Normalizimit Ekonomik të Uashingtonit. Të njëjtat zotime kanë pasur një element strategjik që sy-non ta largojë rajonin nga rrjeti rus i gazit dhe energjisë dhe ta mbajnë rrjetin kinez 5G larg Kosovës dhe Serbisë dhe vendeve të tjera përmes politikës së rrjetit të pastër.<sup>36</sup>

Ballkani Perëndimor është pjesë dhe cak i Nismës Brezi dhe Rruga, ndaj Uashingtoni duhet ta shohë DFC-në si një rival kyç të Kinës që së bashku me programet ekonomike të BE-së duhet ta largojnë ndikimin kinez në ekonominë dhe projektet e infrastrukturës së rajonit,<sup>37</sup> mbyllja e hendekut zhvillimor mes rajonit dhe BE-së është një hap vendimtar për të përafuar ekonominë e rajonit me BE-në dhe për ta mbajtur Kinën larg. Kohët e fundit Kosova dhe Serbia, si pjesë e Marrëveshjes së Uashingtonit, kanë nënshkruar me SHBA-të Marrëveshjet për Stimuj të Investimeve, dhe qëllimet e DFC-së do të jenë të gjera në zgjerimin e investimeve amerikane në fusha të ndryshme që mbështesin rritjen ekonomike.<sup>38</sup> Rajoni do të jetë pjesë e rivalitetit strategjik mes SHBA-ve dhe Kinës, ndërsa zhvillimet mes dy vendeve, si në Tajvan, mund të ndikojnë në qëndrimin e Kinës ndaj Kosovës, e cila ende nuk e njeh pavarësinë dhe së bashku me Rusinë janë pengesa që Kosova të ecë drejt OKB-së. Në këtë kuptim, është i pashmangshëm ndikimi politik dhe ekonomik i rivalitetit, dhe veprimet në rajone pritet të adresojnë shqetësimet e SHBA-ve në lidhje me Kinën, pasi administrata pritet të publikojë një strategji më të gjerë ndaj Kinës në muajt e ardhshëm.<sup>39</sup>

34 Zweers, Wouter et al. (gusht 2020). Kina dhe BE-ja në Ballkanin Perëndimor - një lojë me shumë ze-ro? Raporti Clingendael. Në dispozicion në: <https://www.clingendael.org/sites/default/files/2020-08/china-and-the-eu-in-the-western-balkans.pdf>

35 Mardell, Jacob. (2020, January 23). China's Economic Footprint in the Western Balkans. Bertelsmann Stiftung. Available at: <https://www.bertelsmann-stiftung.de/en/our-projects/germany-and-asia/news/asia-policy-brief-chinas-economic-footprint-in-the-western-balkans>

36 Maksimović, Sandra. (17 shtator 2020). Çfarë nënshkruan Serbia dhe Kosova në Uashington? Ballkani Perëndimor Evropian. Në dispozicion në: <https://europeanwesternbalkans.com/2020/09/17/what-did-serbia-and-kosovo-sign-in-washington/>

37 Intervistë, 9 maj 2021.

38 Zëri i Amerikës. (12 maj 2021). Serbia, Kosova, Greqia shprehin shpresë për interes të qëndrueshëm, investim përmes Agjencisë së SHBA-ve. Në dispozicion në <https://www.voanews.com/europe/serbia-kosovo-greece-express-hope-sustained-interest-investment-through-us-agency>

39 Intervistë, 9 maj 2021.

# AGJENDA DEMOKRATIKE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Presidenti Biden është i qartë për qëllimin e tij se nevojitet një fokus më i madh në adresimin e sfidave të demokracisë dhe fuqizimin e demokracive për të ndaluar rritjen e Kinës dhe vendeve autokratike dhe për të rikthyer besimin në sistemin liberal-demokratik. Sfidat dhe problemet në rajonin e Ballkanit Perëndimor janë të tilla që përputhen me prioritetet e administratës. Mungesa e veprimit kundër tyre krijon hapësirë për ndikim dhe prezencë më të madhe të Kinës dhe akterëve malinj për t'u përfshirë në rajon. Korrupsioni, tendencat autokratike dhe mungesa e progresit në sundimin e ligjit e bëjnë Ballkanin Perëndimor të përshtatshëm për përfshirjen e akterëve të tretë. Në këtë kuptim, shpallja e një urdhri të ri ekzekutiv nga Shtëpia e Bardhë për të përdorur instrumentin e sanksionimit të individëve të përfshirë në korrupsion, sfidimin e ligjit dhe rendit dhe marrëveshjeve të paqes, përfaqëson udhërrëfyesin e ri të politikës së jashtme amerikane në rajon të përqendruar në vlerat demokratike.<sup>40</sup> Korrupsioni, në pikëpamjen e administratës së Biden-it, paraqet një kërcënim për sigurinë kombëtare, dhe elitat kleptokratike në Bosnjë janë një shembull i mirë i ndikimit negativ në të ardhmen e vendit që po shpërbëhet në pragun e Evropës, siç thekson me të drejtë Ischinger.<sup>41</sup>

Ballkani Perëndimor ka parë vitet e fundit një rënie të demokracisë dhe sundimit të ligjit në disa vende, siç është Serbia, ku sundimi autokratik është i fortë dhe sistemi shumëpartiak është i rrezikuar. Nga ana tjetër, është bërë progres në drejtim të demokratizimit, për shembull, në Kosovë e cila tregoi qëndrueshmëri në demokracinë elektorale në rajon, duke mbajtur në më pak se 2 vjet dy zgjedhje parlamentare në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare që kanë siguruar një tranzicion të qetë të pushtetit dhe njohjen e rezultateve.<sup>42</sup> Një fokus më i madh në gjendjen e demokracisë në rajon do të jetë një shtysë e rëndësishme për të çuar përpara integrimin euroatlantik. Zgjidhja e çështjeve politike në rajon nuk mund të ketë shkëputet nga gjendja e demokracisë, luftimi i korrupsionit dhe sundimi i ligjit. Përveç sfidave tradicionale me të cilat është përballur demokratizimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor, pandemia ka shkaktuar një hap prapa në tregues të ndryshëm për të gjitha vendet pa përjashtim.

Nevojitet një përkushtim dhe mbështetje më e fortë ndaj demokracisë për t'iu përgjigjur sfidave me të cilat ballafaqohen vendet. Në prioritetet e saj, ajo ka zbatuar veprimet e politikës së jashtme për më shumë demokraci në botë dhe bashkëpunim shumëpalësh për të mbështetur vendet në adresimin e sfidave me të cilat përballen në rrugëtimin e tyre për të qenë shoqëri të lira, demokratike dhe pluraliste. Angazhimi i tillë ndaj Ballkanit Perëndimor theksohet nga Departamenti i Shtetit në komunikimet e ndryshme në mënyrë dypalëshe përmes letrave të ndryshme që Presidenti Biden dhe Sekretari Blinken u kanë dërguar homologëve të tyre ose në deklaratat e nxjerra, përfshirë atë të G7. Ballkani Perëndimor do të ftohet në Samitin e planifikuar për Demokraci si një takim i nivelit të lartë nën kujdesin e Presidentit Biden, por për shkak të pandemisë data nuk është caktuar ende.<sup>43</sup>

40 Shtëpia e Bardhë. (8 qershor 2021). Urdhri Ekzekutiv për bllokimin e pronave dhe pezullimin e hyrjes në Shtetet e Bashkuara të personave të caktuar që kontribuojnë në situatën destabilizuese në Ballkanin Perëndimor. Në dispozicion në: <https://www.whitehouse.gov/briefing-room/presidential-actions/2021/06/08/executive-order-on-blocking-property-and-suspending-entry-in-to-the-united-states-of-certain-persons-contributing-to-the-destabilizing-situation-in-the-western-balkans/>

41 Ischinger, Wolfgang. (14 maj 2021). Luftoni Korrupsionin! - Op-ed nga Ischinger për Handelsblatt. Në dispozicion në: <https://securityconference.org/en/news/full/ischinger-corruption-handelsblatt/>

42 Instituti Demokratik Kombëtar. (29 prill 2021). Kosovë: Analiza Post-Zgjedhore e Zgjedhjeve Parlamentare të shkurtit 2021. Në dispozicion në: <https://www.ndi.org/publications/kosovo-post-election-analysis-february-2021-parliamentary-elections>

43 Intervistë, 9 maj 2021.

Gjendja aktuale e demokracisë në rajon është ndikuar nga shumë faktorë kryesisht vendorë, por më e rëndësishmja nga ngadalësimi i procesit të integritimit evropian të cilit i ka munguar kushtëzimi për reformat dhe ecjen përpara, sepse ka një ngërç në politikën e zgjerimit në BE. Për Ballkanin Perëndimor kanë mbetur shkopinjtë, kurse stimujt kanë qenë më të paktë, pra qasja nuk ka ndryshuar. Teksa duhet ende të ketë më shumë lidhje mes demokratizimit dhe sundimit të ligjit me progresin në integrimin evropian, që aktualisht është i bllokuar nga ndarjet brenda BE-së, një rol amerikan si në Shqipëri, për të çuar përpara reformat e thella në sundimin e ligjit dhe sektorë të tjerë mund të jetë më efektiv në rajon. Lufta kundër korrupsionit dhe agjenda e bazuar në sundimin e ligjit që synon forcimin e demokracisë, mund të jetë një instrument partneriteti Trans-Atlantik në Ballkanin Perëndimor. Veprimet si ai kundër ish-kryeministrit shqiptar Sali Berisha, i cili së bashku me familjen e tij janë përcaktuar publikisht si persona non-grata nga Departamenti i Shtetit për akte korruptive dhe minim të demokracisë në Shqipëri, mund të kthehen në veprimin më efektiv që duhet ndërmarrë për të lëvizur përpara për reformat e thella në rajon, por edhe për t'u dërguar mesazhe ins-titucioneve në të gjithë Ballkanin Perëndimor për veprime kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.<sup>44</sup> Ky veprim është zbatuar nga Urdhri Ekzekutiv i sapo miratuar që synon të trajtojë korrupsionin dhe sfidat e tjera që pengojnë rajonin, duke paraqitur një njohje të pengesave aktuale në rajon, madje urdhri ekzekutiv në vetvete paraqet një udhërrëfyes të qartë për veprim.<sup>45</sup>

Rajoni nuk do të jetë në gjendje të shtyjë për reforma më të thella dhe demokratizim pa nxitje të jashtme, dhe agjenda e Presidentit Biden për të luftuar korrupsionin, për të kundërvepruar ndaj tendencave autoritare në të gjithë botën, për forcimin e sigurisë zgjedhore dhe respektimin e të drejtave të njeriut, paraqet një platformë të përshtatshme për të siguruar progres në rajon. Kërkohej përballja me sfidat e vendeve të rajonit që po bëjnë hapa mbrapa. Agjenda demokratike e administratës së Biden-it ofron një mundësi për ta luftuar korrupsionin e nivelit të lartë në Ballkanin Perëndimor dhe do të ishte mbështetëse për qëllimet për adresimin e çështjeve të pazgjidhura dypalëshe dhe të brendshme, por gjithashtu do të kundërvepronte ndaj ndikimit malinj të akterëve malinj që zbatojnë korrupsionin strategjik dhe të formave të ndryshme të mbështetjes së krimit të organizuar që është një pjesë shumë thelbësore e ekonomisë politike të rajonit.<sup>46</sup> Një politikë e jashtme e përqendruar në vlera në rajon është mënyra e duhur për të arritur progres.

Një sfidë me të cilën po ballafaqohet rajoni dhe për të cilën mungojnë përpjekjet shumëpalëshe, është fuqizimi i mediave dhe përpjekjet për të luftuar dezinformimin, një fushë në të cilën vendet e rajonit nuk kanë kapacitet të merren më vete pa një angazhim më të fortë siç ndodh në shtetet baltike dhe rajone të tjera në Evropë. Është e paqartë nëse administrata e Biden-it do ta përqendrojë energjinë dhe resurset në luftimin e dezinformimit në Ballkanin Perëndimor si një qëllim i veçantë ose pjesë e përpjekjeve për sigurinë e zgjedhjeve, por përvoja e viteve të fundit tregon se nuk mund të arrihet asnjë progres në çështjet kyçe pa u përballur me sfidën e dezinformimit, dhe meqenëse aktivitetet malinje kanë dëmtuar edhe demokracinë amerikane, Ballkani Perëndimor është shumë i cënueshëm, duke ndikuar kështu në cilësinë e demokracisë në rajon. Rajoni nuk do të jetë në gjendje të ketë një demokratizim të fortë nëse sfidat e sigurisë dhe ato politike nuk shihen si të ndërlidhura dhe nëse nuk aplikohet politika e dënimeve dhe stimujve për të siguruar që rruga e gjatë drejt modelit liberal demokratik të jetë e suksesshme.

44 Departamenti i Shtetit i SHBA-ve. (19 maj 2021). Përcaktimi publik i shqiptarit Sali Berisha për shkak të përfshirjes në korrupsion të madh. Në dispozicion në: <https://www.state.gov/public-designation-of-albanian-sali-berisha-due-to-involvement-in-significant-corruption/>

45 Joseph, Edward P. (11 qershor 2021). Testi i Ballkanit për Biden-in ka mbërritur. Foreign Policy. Në dispozicion në: <https://foreign-policy.com/2021/06/11/bidens-balkans-test-has-arrived/>

46 Maliqi, Agon et al. (2020). Tranzicioni në çfarë? Demokracitë e Ballkanit Perëndimor në një gjendje të ekuilibrit joliberal. Sbunker. Në dispozicion në: <https://sbunker.net/uploads/sbunker.net/files/2020/December/04/Transition-to-what-Western-Balkans-democracies-in-a-state-of-iliberal-equilibrium1607078207.pdf>

# SIGURIA ENERGETIKE NË RAJON

Siguria energjetike në Ballkanin Perëndimor do të jetë një objektiv strategjik gjatë Administratës së Biden-it. Do të jetë prioritet që të kundërveprohet ndaj pranisë së energjisë ruse në rajon duke mbështetur projekte alternative dhe duke i shtyrë qeveritë rajonale të hartojnë politika të reja energjetike, përmes diversifikimit dhe zhvillimit të energjisë së pastër.<sup>47</sup> Greqia po bëhet qendra kryesore e energjisë për Ballkanin Perëndimor, ku SHBA po mbështet Sistemin e Pavarur të Gazit Natyror Alexandroupolis dhe gazsjellësin Interkonektor Greqi Bullgari (IGB), Gazsjellësin Trans Adriatik (TAP), magazinat nëntokësore të gazit në Kavalla Jugore, dhe burimet e ripërtërishme.<sup>48</sup> Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP) mbetet projekti më strategjik i energjisë për SHBA në rajon që lidh tashmë Shqipërinë dhe planifikohet të lidhet me Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën, dhe mund të jetë kundërpeshë ndaj Turkstream-it rus, që shihet si një kërcënim i drejtpërdrejtë për interesat energjetike amerikane në rajon dhe tashmë është nën sanksione me Aktin e Mbrojtjes së Sigurisë së Energjisë në Evropë (PEESA).<sup>49</sup> Serbia dhe BeH janë të lidhura me Turkstream tashmë, kështu që gazi rus po rrjedh në këto dy vende.

Projektet e mbështetura nga SHBA-të në rajon do të rivalizojnë projektet e mbështetura nga Rusia dhe qëllimi strategjik është të kufizohet prania e Rosisë në rrjetin energjetik të Ballkanit Perëndimor, duke krijuar më shumë pavarësi për këto vende dhe duke diversifikuar qasjen në energji për to. Për më tepër, kjo do t'i shërbejë edhe qëllimeve të përgjithshme për të siguruar më shumë pavarësi energjetike në Evropë nga Rusia. Në Kosovën, e cila ende nuk është e lidhur me asnjë tubacion gazi dhe burimet e saj të energjisë janë ende thëngjilli dhe burime të kufizuara të energjisë së ripërtërishme, Shtetet e Bashkuara, përmes Korporatës Sfidë e Mijëvjeçarit (MCC), po mbështesin një Projekt të Zhvillimit të Sektorit të Gazit që synon t'i japë Kosovës qasje në opsion efikas të energjisë termike dhe të mbështesë tranzicionin e energjisë.<sup>50</sup> Që vitin e kaluar kanë filluar diskutimet mes qeverisë së Kosovës dhe SHBA-ve dhe palëve të tjera për të studiuar potencialin për t'u lidhur përmes Maqedonisë së Veriut me Gazsjellësin Trans Adriatik (TAP) dhe për ndërtimin e një termocentrali me gaz.<sup>51</sup> Këto projekte energjetike do të sillnin një ndryshim në rrjetin energjetik të Kosovës së bashku me operacionalizimin e rrjetit elektrik mes Kosovës dhe Shqipërisë, çka i ka dhënë vendit pavarësinë e plotë nga rrjeti energjetik serb. Instrumentet e financimit të MCC dhe DFC do të luajnë një rol të rëndësishëm në të ardhmen energjetike të Kosovës. Kjo duket se do të lidhë angazhimin politik amerikan me një program stimulimi ekonomik, ku tani programet më të dakorduara mund të shfrytëzohen më mirë në të ardhmen me qëllime politike në të gjithë rajonin, jo vetëm në Kosovë.

<sup>47</sup> Departamenti i Shtetit i SHBA-ve. (26 prill 2021). Përkushtimi i SHBA-ve ndaj Ballkanit Perëndimor. Në dispozicion në: <https://www.state.gov/u-s-commitment-to-the-western-balkans/>

<sup>48</sup> New Europe.(21 gusht 2020). SHBA dhe Greqia zgjerojnë bashkëpunimin energjetik. Në dispozicion në: <https://www.neweurope.eu/article/us-greece-to-expand-energy-cooperation/>

<sup>49</sup> Departamenti i Shtetit i SHBA-ve. (9 prill 2021). Akti për Mbrojtjen e Sigurisë Energjetike të Evropës (PEESA), i ndryshuar. Në dispozicion në: <https://www.state.gov/protecting-europes-energy-security-act-peesa/>

<sup>50</sup> New Europe.(21 gusht 2020). SHBA dhe Greqia zgjerojnë bashkëpunimin energjetik. Në dispozicion në: <https://assets.mcc.gov/content/uploads/Final-Kosovo-Compact-609g-CN-Tranche-II.pdf>

<sup>51</sup> Intervistë, 9 maj 2021.

Sfidat e Kosovës në sektorin energjetik do të jenë të mëdha në vitet e ardhshme. Burimi kryesor energjetik ka qenë dhe mbetet thëngjilli dhe i gjithë diskutimi rreth sektorit të energjisë në Kosovë është përqendruar në përdorimin e thëngjillit për prodhimin e energjisë. Në përpjekjet për të trajtuar ndryshimet klimatike, udhëheqësit e G7 kanë rënë dakord të ndalojnë financimin për termocentralet me thëngjill, çka patjetër do ta prekë Kosovën, që do të kenë më pak mundësi financiare në dispozicion për të ecur përpara me projektin për një termocentral të ri thëngjilli.<sup>52</sup> Në të kaluarën, projekti i energjisë me thëngjill "Kosova C" nuk ka kaluar pa kundërshtime dhe pas më shumë se një dekade procedurash dhe pune, projekti ka dështuar, duke krijuar një hendek të thellë në kapacitetet e prodhimit të energjisë në Kosovë. Kjo e bën të pashmangshëm një debat strategjik për të ardhmen energjetike të vendit, ku do të gjejnë vend projekte të tilla si tubacionet e gazit, të cilat janë gjithashtu me rëndësi gjeopolitike. Qeveria e Kosovës tashmë ka theksuar se fokusi i tyre është në energjinë e pastër, furnizimin e sigurt dhe çmimet e përbalueshme, por duke treguar edhe synimin për të siguruar një konsensus kombëtar mbi politikat e nevojshme të energjisë.<sup>53</sup>

Është thelbësore që përveç diskutimit për burimin e energjisë të ketë një fokus në infrastrukturën e nevojshme dhe sigurinë e saj. Kjo siguron jo vetëm adresimin e sfidave energjetike, por gjithashtu hap mundësi për investime në infrastrukturën kritike dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Në të njëjtën kohë, debati për energjinë në Kosovë është thelbësor për të pasur në fokus opsionet që janë në dispozicion dhe për të siguruar pavarësinë energjetike të Kosovës nga vendet dhe projektet që nuk janë nga sfera euro-atlantike.

52 Reuters. (21 maj 2021). Duke vepruar për klimën, G7 pranon të ndalojë financimin ndërkombëtar për thëngjillin. Në dispozicion në: <https://www.reuters.com/business/energy/g7-countries-agree-stop-funding-coal-fired-power-2021-05-21/>

53 Zyra e Kryeministrit të Kosovës. (5 maj 2021). Kryeministri Kurti takon ushtruesin e detyrës së Shefit Ekzekutiv të Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit, Mahmoud Bah. Në dispozicion në: <https://kryeministri.rks-gov.net/en/prime-minister-kurti-meets-the-acting-chief-executive-officer-of-the-millennium-challenge-corporation-mahmoud-bah/>

# REAGIMI NDAJ PANDEMISË COVID-19 NË BALLKANIN PERËNDIMOR

**P**andemia ka paraqitur një sfidë për të gjitha vendet në rajon, ku ndikimi ekonomik dhe menaxhimi i pandemisë me sigurimin e vaksinave i kanë sfiduar qeveritë në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Vaksinimi është bërë një çështje thelbësore për çdo qeveri. Efektiviteti i qeverive dhe stabiliteti i tyre politik varet gjithashtu nga sigurimi i vaksinave. Përveç çështjeve shëndetësore të lidhura me pandeminë, kjo ka çuar në një konkurrencë të shtuar nga vende dhe akterë të ndryshëm për të rritur ndikimin e tyre në rajon dhe për të siguruar qasje në ndihmë dhe vakcina. Vendet e rajonit nuk kanë bashkëpunuar për qasjen e përbashkët në vakcina ose për adresimin e sfidave të pandemisë, përkundrazi, ndoshta pandemia ka treguar se sa joefektive kanë qenë strukturat e bashkëpunimit rajonal në një kohë krize për të gjithë rajonin. Iniciativat rajonale kanë munguar, ka pasur më shumë shtetëzim në sipërfaqe, ndërsa të vetmet raste kur është treguar ndonjë veprim rajonal kanë qenë me nxitjen e BE-së ose në raste të kufizuara të SHBA-ve.

Në të njëjtën kohë, përveç veprimeve individuale nga vendet e rajonit, disa vende si Kosova, Maqedonia e Veriut ose BeH kanë pasur shpresa të mëdha për qasje në programet COVAX dhe donacionet e BE-së, të cilat kanë dëshmuar të jenë të vonuara dhe të pamjaftueshme në numër për të siguruar vakcina të mjaftueshme. Sot në rajon ekziston një mozaik i ndryshëm i qasjes në vakcina. Shumë vende si Serbia kanë përdorur vakcina të prodhuara nga Rusia dhe Kina, me vende të tjera si Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia dhe BeH që kanë një qasje të ngjashme, përveç Kosovës. Mozaiku i vaksinimit tregohet gjithashtu në numrin e vaksinimeve përveç origjinës së vaksinave, por nga fundi i qershorit po arrihet progres në qasje.

Administrata e Biden-it ka njoftuar një plan me të cilin shumë vende do të përfitojnë nga shpërndarja e vaksinave nga SHBA-të, në të cilin Kosova nga Ballkani Perëndimor u përfshi ndër vendet e para,<sup>54</sup> ndërsa përmes G7 është paraqitur një plan më ambicioz për të ofruar 1 miliard vakcina me programin Covax, përmes të cilit vaksinat do të shpërndahen për të siguruar qasje më të madhe, por edhe për të kundërvepruar ndaj konkurrencës kineze dhe ruse për shpërndarjen e vaksinave.<sup>55</sup> Një lëvizje e tillë do të rriste kapacitetin e vaksinimit në të gjithë rajonin, kryesisht në vendet që kanë më pak qasje aktualisht, por gjithashtu do të ngrinte imazhin amerikan në rajon dhe në botë, nga një Amerikë e izoluar gjatë administratës së Trump-it në një Amerikë më të hapur dhe bashkëpunuese gjatë administratës së Biden-it, sigurisht duke ofruar mundësi të reja për veprim ndaj vështirësive politike

54 Shtëpia e Bardhë, (3 qershor 2021). PASQYRË E FAKTEVE: Administrata Biden-Harris zbulon strategjinë për ndarjen globale të vaksinave, duke shpallur planin e alokimit për 25 milionë dozat e para që do të ndahen globalisht. Në dispozicion në: <https://www.whitehouse.gov/briefing-room/statements-releases/2021/06/03/fact-sheet-biden-harris-administration-unveils-strategy-for-global-vaccine-sharing-announcing-allocation-plan-for-the-first-25-million-doses-to-be-shared-globally/>

55 Reuters. (13 qershor 2021). G7 dakordohet për dhurimin e 1 miliard vaksinave kundër COVID - komunikatë. Në dispozicion në: <https://www.reuters.com/world/g7-provides-1-billion-covid-vaccine-doses-will-work-give-more-communicate-2021-06-13/>



# KONKLUSIONE

Marrë parasysh përvojën e Joe Biden-it në Ballkanin Perëndimor, pritjet janë të mëdha që administrata e tij do t'i trajtojë çështjet kyçe politike, ekonomike dhe të sigurisë në rajon. Siç duket, pritjet nuk do të përkthehen në rezultate të menjëhershme, për shkak të pandemisë, rënies së primatit amerikan dhe evropian në rajon, dhe mungesës së veprimeve nga BE-ja për procesin e zgjerimit. Administrata e Biden-it përballlet me sfida dhe mundësi në Ballkanin Perëndimor për të mbyllur mosmarrëveshjet e pazgjidhura dypalëshe dhe sfidat e brendshme që po e mbajnë rajonin në status quo dhe u japin shanse akterëve malinj që të depërtojnë.

Çështja kyçe mbetet që Kosova të nxirret nga izolimi dhe të arrihet progres në integrimin e saj ndërkombëtar. Kjo do të kërkojë më shumë koordinim dhe veprime të përbashkëta nga Uashingtoni dhe Brukseli dhe jo përpjekje të vetmuara, por me një agjendë të qartë dhe kornizë kohore. Nuk ka shumë gjasa që Kosova dhe Serbia të arrijnë progres në dialog së shpejti, por Uashingtoni duhet t'u ndihmojë të dyja palëve, dhe veçanërisht Kosovës, për ta zhbllokuar izolimin ndërkombëtar dhe evropian. Vonesat e mëtejshme vetëm do t'i largojnë palët nga procesi, i cili tashmë nuk ka kredibilitet në Kosovë, dhe do t'i mbajnë peng shoqëritë. Teksa Bosnja dhe Hercegovina mbetet një çështje e vështirë për t'u zgjidhur, ruajtja e një BeH të bashkuar dhe mbrojtja e integritetit territorial dhe sovranitetit të saj është vendimtare për stabilitetin dhe paqen në rajon. Uashingtoni ka aftësinë dhe fuqinë për të kundërshtuar tendencat shpëputëse dhe për të kryer disa reforma kushtetuese që do ta bënin vendin më funksional. Ngërçi aktual dhe situata e paqëndrueshme në BeH e bëjnë atë një objektiv të lehtë për përfshirjen ruse për ta destabilizuar rajonin.

Përveç nevojës për një politikë të qartë mbi sfidat tradicionale, kohët kanë ndryshuar dhe kërkohet qartësi në temat thelbësore për të ardhmen e rajonit. Sa e suksesshme do të jetë administrata e Biden-it në rajon për t'i adresuar këto sfida varet shumë nga fakti nëse mund të arrihet një konsensus transatlantik se perspektiva e anëtarësimit në NATO për Kosovën dhe Bosnjën dhe Hercegovinën do të jetë e hapur dhe nëse BE-ja do të arrijë të dalë nga ngërçi i zgjerimit.

Vitet e ardhshme mund të jenë strategjike për sigurimin e një perspektive më dinamike për rajonin, ndërsa paaftësia për ta nxjerrë rajonin nga gjendja aktuale e stagnimit dhe dështimi për t'i mbyllur mosmarrëveshjet e pazgjidhura dypalëshe që përkeqësojnë marrëdhëniet politike në rajon, rrezikon qëllimet strategjike të Shteteve të Bashkuara dhe BE-së. Kjo kërkon ndërlidhjen e angazhimit politik me një agjendë të rimëkëmbjes ekonomike, duke theksuar kështu luftën kundër korrupsionit, forcimin e institucioneve demokratike dhe shoqërive multi-etnike.

Përveç këtyre çështjeve kyçe politike, administrata e Biden-it ofron mundësi për të punuar me vendet e rajonit për të garantuar siguri më të fortë energjetike dhe qasje në më shumë diversifikim të sektorit të energjisë, çka do të ishte e dobishme për ekonominë, por gjithashtu duke mbështetur rimëkëmbjen ekonomike duke e ulur depërtimin kinez dhe rus në infrastrukturën kyçe dhe projektet ekonomike.

Katalogimi në botim – **(CIP)**  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

32(497)  
929 Joe Biden

Agjenda e Biden-it : Si mundet administrata e re t'i ndihmojë Ballkanit Perëndimor të dalë nga stagnimi / Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. - Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2021. - 27 f. : ilustr. ; 21cm.

**ISBN 978-9951-799-40-9**

## AGJENDA E BIDEN-IT:

SI MUNDET ADMINISTRATA E RE T'I  
NDIHMJË BALLKANIT PERËNDIMOR  
TË DALË NGA STAGNIMI

AUTHOR: MUHAMET BRAJSHORI

ISBN 978-9951-799-40-9



9 789951 799409